



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:045300

Datë: 13.02.2024

Numri i dokumentit: 05320437

KPPP.nr. 1848/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Corporation Financiere Europeenne SA, me seli në Geneve – Zvicër, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.M., avokat nga Gjakova, dhe debitorëve N.T.P “Legenda” me seli në Prishtinë dhe Sh.D. nga Prishtina, rr. “Dubrovniku”, nr. 6, me bazë përmbartimi sipas titullit ekzekutiv, pas shqyrtimit paraprak të lëndës, jashtë seancës, me datë 13.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit Corporation Financiere Europeenne SA, me seli në Geneve – Zvicër, dhe debitorëve N.T.P “Legenda” me seli në Prishtinë dhe Sh.D. nga Prishtina.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Corporation Financiere Europeenne SA, me Aktvendimin E.nr. 1093/2012, të datës 23.04.2013, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorëve N.T.P “Legenda” me seli në Prishtinë dhe

Sh.D. nga Prishtina, për pagesën e detyrimit sipas titullit ekzekutiv në lartësi prej EUR 50,378.00.

Debitori ndaj aktvendimit në fjalë ka paraqitur prapësim, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E.nr. 1093/2012, të datës 12.09.2014, ka refuzuar prapësimin si të pabazuar duke lënë në fuqi aktvendimin mbi lejimin e përmbarrimit. Ndaj këtij aktvendimi debitori ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës së debitorit, me Aktvendimin Ac.nr. 4323/14, të datës 26.01.2015, e ka refuzuar ankesën si të pabazuar, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, E.nr. 1093/2012, të datës 12.09.2014 e ka vërtetuar.

Pasi që aktvendimi mbi lejimin e përmbarrimit ka marr formë të prerë, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin E.nr. 1093/2012, të datës 01.02.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike, ndërsa lëndën e ka dërguar pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarrimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarrimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbarrimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarrimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarrimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarrimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është*

i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë.”

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt zbatimin e përmbarimit sipas aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit i cili ka marr formë të prerë, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së. Andaj, në mungesë të mjetit juridik, në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është zbatimi i aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit i formës së prerë nga gjykata si organ përmbarues, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1848/23, datë 13.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.